

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2023

### LËNDA: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30	31	32
Pikët								
Kërkesa	33	34a	34b	34c	34d			
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Alpinisti**

Është një majë që të fton si një vashë për të falur trupin e saj të brishtë. Ti nisesh drejt saj. Që në çastin kur fillon të ngjitesh, te secila krijesë njerëzore sheh nga një armik të përbetuar që synon ta vrasë idealin tënd të ngjitjes lart. Armik ke edhe krijesat e tjera, ku mund të fshihet intriga njerëzore. Armik ke diellin që t'i nxin pamjet dhe ta humb orientimin. Armik ke akullin nën këmbét tua që ecin në një drejtim. Ti ke vetëm armiq. Edhe gjymtyrët, që mund të mos i nënshtrohen vullnetit tënd, gjersa ngjitesh drejt majës ku valon vetëm flamuri i atij që është ngjitur i fundit - flamuri i fituesit. Është pak e rëndësishme kush është ngjitur i pari. E rëndësishme është se kujt i valon flamuri...

... Dhe kur arrin në atë majë, nëse arrin ndonjëherë, ti s'e ndien, por ata që kanë mbetur poshtë, pra njerëzit e vegjël dhe të pavlefshëm (se kështu duken ata nga lart), pëshpëritin se ke ndryshuar shumë. Po këto pohime vdesin thellë në qeniet e tyre. I vret hija jote e madhe që shtrihet kudo në qeniet e tyre. Ata thonë, me vete: - Kështu ndodh me secilin që ngjitet në majën më të lartë që quhet FRON. Majë e cila të fton si një vashë e brishtë të ta falë humbjen, të cilën ti e ruan si trofe dhe e shkëmben vetëm me jetën tënde.

- 1. Cila është gjuha e përdorur në këtë tekst? 1 pikë**
  - A) Gjuhë teknike dhe e drejtpërdrejtë.
  - B) Gjuhë pëershkruese subjektive.
  - C) Gjuhë informuese objektive.
  - D) Gjuhë analitike objektive.
  
- 2. Fjala e nënizuar në fjalinë: "Dhe kur arrin në atë majë, nëse arrin ndonjëherë, ti s'e ndien, por ata që kanë mbetur poshtë, pra njerëzit e vegjël dhe të pavlefshëm, pëshpëritin se ke ndryshuar shumë.", është 1 pikë**
  - A) trajtë e shkurtër.
  - B) përemër lidhor.
  - C) lidhëz.
  - D) nyje.
  
- 3. Sipas autorit të këtij teksti, dy nga armiqtë e njeriut që lidhen me fenomene natyrore, janë: 1 pikë**
  - A) Dielli dhe krijesat njerëzore përreth, që ushqehen nga intrigat dhe xhelozia.
  - B) Dielli dhe vasha me trupin e saj të brishtë, që të fton drejt aventurave.
  - C) Dielli dhe akulli, që i ke nga pas që në hapat e para drejt ngjitjes.
  - D) Akulli dhe gjymtyrët e tua që nuk i nënshtrohen vullnetit tënd.
  
- 4. Si i kuptoni fjalitë: "Është pak e rëndësishme kush është ngjitur i pari. E rëndësishme është se kujt i valon flamuri..." 1 pikë**
  - A) Lufta për ekzistencë e bën njeriun më të fortë.
  - B) Njeriu ngjit malet për t'i dhënë kuptim jetës së tij.
  - C) Njeriu jeton me ambicjen për të arritur majat e synimeve të veta.
  - D) Alpinizmi është një nga sportet më të bukur e më të shëndetshëm.

5. Një nga karakteristikat e gjuhës së përdorur në këtë tekxt është: **1 pikë**
- A) mbizotërimi i formave joveprore të foljes.
  - B) objektiviteti i skajshëm në paraqitjen e idesë.
  - C) organizimi përmes fjalive të shkurtra të drejtëpërdrejta.
  - D) përdorimi i detajeve shqisore dhe mjeteve të shprehësisë.
6. Në fjalinë: *"Dhe kur arrin në atë majë, nëse arrin ndonjëherë, ti s'e ndien, por ata që kanë mbetur poshtë, pra njerëzit e vegjël dhe të pavlefshëm, pëshpëritin se ke ndryshuar shumë."*, folja e nënvizuar është në: **1 pikë**
- A) kohën e kryer
  - B) kohën e tashme
  - C) kohën e ardhme
  - D) kohën e kryer të thjeshtë.
7. Cila nga fjalitë e mëposhtme është e thjeshtë? **1 pikë**
- A) E rëndësishme është se kujt i valon flamuri.
  - B) Është pak e rëndësishme kush është ngjitur i pari.
  - C) Armik ke akullin nën këmbët tua që ecin në një drejtim.
  - D) Ti ke vetëm armiq të përbetuar nën këmbët tua të pavullnetshme e të lodhura nga rruga e gjatë.
8. Fjala të pavlefshëm në fjalinë: *"Dhe kur arrin në atë majë, nëse arrin ndonjëherë, ti s'e ndien, por ata që kanë mbetur poshtë, pra njerëzit e vegjël dhe të pavlefshëm, pëshpëritin se ke ndryshuar shumë."*, është fjalë: **1 pikë**
- A) e parme.
  - B) e përbërë.
  - C) e përngjitur.
  - D) e prejardhur.
9. Në fjalinë: *"Ata thonë, me vete: - Kështu ndodh me secilin që ngjitet në majën më të lartë që quhet FRON."*, fjala e nënvizuar është: **1 pikë**
- A) përemër i pacaktuar.
  - B) përemër vvetvetor.
  - C) përemër dëftor.
  - D) përemër vtor.
10. Shumësi i grupit emëror *mal i lartë*, është: **1 pikë**
- A) male të larta.
  - B) male të lartë.
  - C) malet e larta.
  - D) malet e lartë.
11. Zbuloni formën e pashtjelluar foljore të përdorur në fjalinë e dhënë: *"Është një majë që të fton si një vashë për të të falur trupin e saj të brishtë."* **1 pikë**

Forma e pashtjelluar foljore: \_\_\_\_\_

12. Në fjalinë: "Armik ke diellin që t'i nxin pamjet dhe ta humb orientimin.", gjeni një kundrinor. Përcaktoni llojin e tij dhe tregoni me se është shprehur. 3 pikë

Kundrinori: \_\_\_\_\_

Lloji: \_\_\_\_\_

Me se është shprehur: \_\_\_\_\_

13. Zbuloni dy karakteristika gjuhësore të këtij teksti, tipike për llojin të cilit ai i përket. Mendimin mbështeten me ilustrime nga teksti. 4 pikë

Karakteristika 1 \_\_\_\_\_

Ilustrimi \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Karakteristika 2 \_\_\_\_\_

Ilustrimi \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

14.

- a) Në fjalinë e mëposhtme gjeni gjymtyrët homogjene. 1 pikë

... Dhe kur arrin në atë majë, nëse arrin ndonjëherë, ti s'e ndien, por ata që kanë mbetur poshtë, pra njerëzit e vegjël, njerëzit e pavlefshëm, pëshpëritin se ke ndryshuar shumë.

Gjymtyrët homogjene: \_\_\_\_\_

- b) Cili është funksioni i tyre sintaksor në fjalinë e dhënë? 1 pikë

15. Çfarë simbolizon maja drejt së cilës ngjitet njeriu i këtij fragmenti? 1 pikë

  

---

---

16. Shpjegoni imazhin që ju krijon krahasimi me vashën në fjalinë hyrëse të shkrimit. 2 pikë

---

---

---

17. Cilat janë dy kategoritë e njerëzve që shpalos autor i paragrafin e dyltë. Cilat janë raportet mes tyre sipas këndvështrimit të tij? 3 pikë

---

---

---

## PJESA II

### Naim Frashëri

#### Bukuria

M'iku me vrap djalëria

E më la mbi dhe të shkretë,

Më erth shtriga pleqëria

Pshehtazi, si qen i qetë.

Opopo, ç'më gjet, o shokë!

Do të qanj me thes më kokë!

O ditët e djalërisë,

Që kishit shumë gjëzime,

Ratë në det t'arratisë,

Më latë në hidhërimë.

Tani jetën ç'e dua,

Më s'ësht' e shkreta përmua!

Ti o bukuroshja ime,

Të ritë ma paç përjetë,

Kurrë mos pafsh hidhërimë,

Të dashtë Zot' i vërtetë!

Syri yt mos u venitë,

Si hëna u përtëritë!

**18. Poemthi "Bukuria" i Naim Frashërit bën pjesë në llojin e lirikës:**

**1 pikë**

- A) së peizazhit.
- B) së dashurisë.
- C) atdhetare.
- D) meditative.

**19. Identifikoni llojin e rimës së përdorur:**

**1 pikë**

- A) E përputhur.
- B) E kryqëzuar.
- C) E përmbyllur.
- D) E brendshme.

**20. Vargu i përdorur në këtë fragment është:**

**1 pikë**

- A) 8 – rrokësh.
- B) 10 – rrokësh.
- C) 12 – rrokësh.
- D) 16 – rrokësh.

21. Në cilin nga vargjet është përdorur apostrofa? 1 pikë
- A) Më s'ësht' e shkreta për mua
  - B) Do të qanj me thes më kokë
  - C) Të dashtë zot' i vërtetë
  - D) O ditët' e djalërisë
22. Poezitë e poemthit "Bukuria" i bashkon: 1 pikë
- A) varësia kuptimore.
  - B) varësia kronologjike.
  - C) meditimë për atdhetarizmin.
  - D) meditimë për ndjenjën e dashurisë.
23. Në fragment shqetësimi i unit lirik lidhet me: 1 pikë
- A) frikën nga vdekja.
  - B) trishtimin për largimin e vashës.
  - C) dhimbjen përballë kohës që rrjedh.
  - D) pafuqinë në raport me Perëndinë.
24. Poeti në vargjet e fundit uron: *Syri yt mos u venitë,/Si hëna u përtëritë!* Cila nga alternativat përmbush më mirë imazhin që kërkon të zgjojë autorit? 1 pikë
- A) Ashtu sikurse hëna me formën e saj të përsosur habit syrin e një piktori, ashtu edhe vasha me hiret e saj të pakrahasueshme të mahnitë shpirtin e të dashuruarit.
  - B) Ashtu sikurse hëna që me dritën e saj ndriçon natën e errët, ashtu edhe vasha me bukurinë e saj të sfidojë natën.
  - C) Ashtu si hëna që përjetësish shmang errësirën e natës, edhe vasha me bukurinë e saj të feksë përjetësish për të zhdukur errësirën.
  - D) Ashtu si hëna që përtërihet në çdo rilindje dhe hedh dritën e saj natën, ashtu edhe vasha të ripërtërihet pa njojur zbehje nga vitet dhe të ndriçojë botën shpirterore të unit lirik.
25. Gjatë leximit të poemthit "Bukuria" zbulohet: 1 pikë
- A) shpirti romantik i heroit.
  - B) shpirti luftarak i heroit.
  - C) shpirti i ftotë i heroit.
  - D) shpirti realist i heroit.
26. Në vargjet: *"Ti o bukuroshja ime, / Të ritë ma paç përjetë!"*, folja paç është në mënyrën: 1 pikë
- A) dëshirore.
  - B) habitore.
  - C) dëftore.
  - D) lidhore.
27. Atmosfera mbizotëruese e fragmentit është: 1 pikë
- A) trishtimi.
  - B) mahnitja.
  - C) lumturia.
  - D) ngazëllimi.

28. Identifikoni një kahasim në fragment dhe shpjegoni rolin e tij artistik. **2 pikë**

Kahasimi: \_\_\_\_\_

Roli artistik: \_\_\_\_\_

29. Dalloni në fragment dy çifte vargjesh, një që formon rimë foljore dhe një që formon rrimë emërore. Cili është efekti që krijohet? **3 pikë**

Rimë foljore\_\_\_\_\_

Rimë emërore\_\_\_\_\_

Efekti që krijohet\_\_\_\_\_

30. Poeti Naim Frashëri mbështetet në krijimtarinë popullore. Zbuloni dy tipare të kësaj krijimtarie, duke i ilustruar me shembuj nga fragmenti. **4 pikë**

Tipari 1: \_\_\_\_\_

Shembulli: \_\_\_\_\_

Tipari 2: \_\_\_\_\_

Shembulli: \_\_\_\_\_

31. Në shprehjen e hidhërimit Naimi gërshton notat tragjike me ato komike. Çfarë funksioni stilistik merr kjo në poezi? Ilustrojeni me shembuj nga fragmenti. **3 pikë**

---

---

---

32. Zbuloni në fragment një tipar të heroit romantik. Ilustrojeni me një shembull nga fragmenti. **2 pikë**

Tipari 1: \_\_\_\_\_

Shembulli në fragment: \_\_\_\_\_

33. Analizoni gjendjen shpirtërore të heroit në këtë fragment. Çfarë e ka shkaktuar atë? **2 pikë**

---

---

---

---

Pjesa III

34. A jeni dakord me qëndrimin e autorit në tekstin e pjesës së parë, për raportet mes njerëzve në shoqërinië e sotme? Shpjegoni pozicionin tuaj përmes një eseje argumentuese. **8 pikë**

Shtjellimi i idesë (34 a)	Organizimi dhe struktura (34 b)	Stili dhe origjinaliteti (34 c)	Saktësia gjuhësore (34 d)	Totali 34
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë